



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:012210

Datë: 08.08.2022

Numri i dokumentit: 03332949

P.nr.10/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Hoxha, si dhe me sekretarin juridik Ilvi Raba, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve J. R. nga Rahoveci, i ngarkuar me veprat penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së* dhe për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, dhe kundër të akuzuarit F. R. nga Rahoveci, i ngarkuar me veprat penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1493/2019 të datës 15.01.2020, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, publik, me datë 26.07.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Qazim Xharra si dhe të akuzuarve J. R. dhe F. R., më datë 28.07.2022, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 08 gusht 2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

J. R., i lindur me datë ... në Rahovec, ku dhe jeton, në rrugën “T. Z.”, p.nr., nga i ati I. dhe e ëma S., e gjinisë Sh., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, përfitues i ndihmës sociale, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

F. R., i lindur me datë ... në Rahovec, ku dhe jeton, në rrugën “T. Z.”, p.nr., nga i ati I. dhe e ëma S., e gjinisë Sh., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I akuzuari J. R.

I. Me datë 17.10.2019, rreth orës 21:20 min., në Rahovec, në rrugën “B. I.”, nën ndikimin e alkoolit, shkaktonte rrezik të përgjithshëm, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit “...-... Golf II”, me targa të rexhistrimit ...-...-..., dhe vëllai i tij, ishte pasagjer në ulësen e pasme, me të arritur në rrugën “B. I.”, në Rahovec, e vëren të dëmtuarën E. Z. nga Rahoveci, e cila ishte duke ecur në këmbë, dhe menjëherë kthehet me vrull me automjetin e i shkon nga pas dhe me pjesën e përparme të automjetit, nga krahu i djathtë godet qëllimisht të dëmtuarën duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në gjurin e këmbës së majtë, lëndime këtu të përshkruara më hollësisht në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr. N. H., të datës 15.12.2019.

-Me këto veprime kanë kryer veprën penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së.*

Të akuzuarit J. R. dhe F. R.

II. Më datë 17.10.2019, rreth orës 21:20, në Stacionin Policor në Rahovec, të pandehurit në bashkëveprim kanë lajmëruar rrejtshëm si kryes të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë, familjarët e të dëmtuarës E. Z. nga Rahoveci, duke ditur se të njëjtit nuk janë kryes të veprës penale, në atë mënyrë që të pandehurit kanë raportuar se familjarët e të dëmtuarës i’u kanë dëmtuar parafangon e parë të automjetit të tyre “VW-19E Golf II”, ku më pas është vërtetuar se vetë të pandehurit e kanë dëmtuar parafangon e automjetit duke e goditur qëllimisht të dëmtuarën, me çka i kanë shkaktuar lëndime trupore.

-Me këto veprime kanë kryer veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.2, 46 par.1 pika 1.4, 47, 48, 69, 70, nenit 356 par.1 dhe 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe nenit 248, 365 si dhe 370 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

G J Y K O N
ME DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit J. R.,

Për veprën penale si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton), dënim me burg në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj.

Për veprën penale si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton), dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Të akuzuarit F. R.,

Për veprën penale si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton), dënim me burgim prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i njëjti nuk kryen vepër të re penale.

Gjykata, në harmoni me nenin 80 të KPRK-së, të akuzuarit **J. R.** për të gjitha pikat e aktakuzës, i shqipton këtë:

DËNIM UNIK

Duke i vërtetuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej shtat (7) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i njëjti nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara E. Z., e lindur më datë ... në Rahovec, me vendbanim në rrugën “B. I.”, p.nr., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

I akuzuari J. R. lirohet pjesërisht nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, obligohet që të paguaj shpenzimet për ekspertizën mjeko-ligjore të punuar nga dr.N. H. të datës 15.12.2019, shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen i akuzuari F. R. t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: Në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) Euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën, PP/II.nr.1493/2019 të datës 15.01.2020, kundër të akuzuarve J. R. nga Rahoveci, i ngarkuar me veprat penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së* dhe për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, dhe kundër të akuzuarit F. R. nga Rahoveci, i ngarkuar me veprat penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*.

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështirim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret, vepra penale është kryer në Rahovec, andaj Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprën penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së*, është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) dhe për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim*

i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose më burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet dhe meqenëse të njëjtat vepra nuk janë paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës, PP/II.nr.1493/2019 të datës 15.01.2020, më datë 26 korrik 2022 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor.

Prokurori i Shtetit, para se të bëjë leximin e aktit akuzues bëri përmirësimin e një gabimi teknik ku për veprën në pikën II të dispozitivit të aktakuzës gabimisht është shënuar neni 390 par.1 të KPRK-së, e në fakt duhet të jetë me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së, pjesa tjetër e aktakuzës së lartcekur mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari J. R., lidhur me deklarimin mbi fajësinë apo pa fajësinë tij ka deklaruar se pranon fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohet, duke shtuar se ndjehet i penduar për rastin që ka ndodhur, palës së dëmtuar E. Z. i ka kërkuar falje, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale duke kërkuar nga gjykata që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësues si pranimi i fajësisë, gjendjen ekonomike dhe sociale, pasi që është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë dhe përfitues i ndihmave sociale.

I akuzuari F. R. lidhur me deklarimin mbi fajësinë apo pa fajësinë tij ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndjehet i penduar për veprimet e tij dhe njëkohësisht i ka kërkuar falje palës së dëmtuar. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit të merren në konsideratë rrethanat lehtësuese.

Prokurori i Shtetit, Qazim Xharra, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në seancën e shqyrtimit të fillestar gjyqësor ka deklaruar duke pas parasysh se të akuzuarit e pranuan fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe faktet se të njëjtat e kanë kuptuar natyrën, pasojat dhe favoret e pranimit të fajit, pranimi i fajit u bë vullnetarisht nga të pandehurit po ashtu faktet se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza e në bazë të cilave edhe është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv nën I dhe II të kësaj aktakuze me çka edhe përmbushen edhe elementet qenësore të veprave penale për të cilat ngarkohen të akuzuarit po ashtu edhe fakti se akuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban janë provat të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, prokuroria shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë. Gjykatës i propozon që të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe t'ju shqiptojë një dënim të paraparë me ligje duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprave penale për të cilët akuzohen. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh qëllimin e dënimit si dhe individualizimit të dënimit si dhe të ketë parasysh rrethanat lehtësuese pranimi i fajit, pendimi i thellë, kërkim falje publike këtu para gjykatës, ndërsa sa i për ketë rrethanave rënduese ia lejmë në vlerësim të gjykatës si dhe të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Pasi gjyqtari i vetëm gjykues u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 248 të KPPRK-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë për të akuzuarin J. R., për veprat penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së* dhe veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, dhe për të akuzuarin F. R. për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprat penale, të përshkruar në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë të bërë nga të akuzuarit, ku për shkak të pranimit të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes.

Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 257 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale për të cilën akuzohen. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e tyre, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues, e për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i kanë kundërshtuar, por kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen.

Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së, në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së* dhe të veprës penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, ku për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Për të akuzuarin J. R., gjykata si rrethanë rënduese përveç faktit se vepra penale është kryer me shkallë të lartë të dashjes, rrethanë tjetër rënduese nuk gjeti. Ndërsa si rrethana lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i akuzuari për veprat penale për të cilat akuzohet, pendimi i thellë për kryerjen e veprave penale, ku që nga faza e hershme e hetimeve, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor, ka theksuar se është penduar për atë që ka bërë, ku këtë pendim e dëshmon edhe me vet faktin duke i kërkuar falje palës së dëmtuar, bashkëpunimi i tij me gjykatën, gjendjen e tij sociale dhe ekonomike si dhe keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari për rastin e ndodhur. Një fakt tjetër që gjykata mori për bazë

në matjen e këtij dënimi është se i akuzuari më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë rast penal, me vendim të formës së prerë.

Për të akuzuarin F. R., gjykata si rrethanë rënduese veçanërisht rënduese nuk gjeti. Ndërsa si rrethana lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i akuzuari për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimi i thellë për kryerjen e veprës penale, ku që nga faza e hershme e hetimeve, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor, ka theksuar se është penduar për atë që ka bërë, ku këtë pendim e dëshmon edhe me vet faktin duke i kërkuar falje para gjykatës, bashkëpunimi i tij me gjykatën, gjendjen e tij sociale dhe ekonomike, si dhe keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari për rastin e ndodhur. Një fakt tjetër që gjykata mori për bazë në matjen e këtij dënimi është se i akuzuari më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë rast penal, me vendim të formës së prerë.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të akuzuarit J. R. i shqiptoj dënimin unik me burgim prej shtatë (7) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në fat prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i njëjti nuk kryen vepër të re penale. Gjykata dënimin me gjobë e shqiptoi për faktin se për veprën penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së*, është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite ndërsa për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së*, është paraparë dënim në mënyrë alternative me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vite. Gjykata përkitazi me dënimin me kusht morri për bazë edhe kërkim faljen e të akuzuarit si dhe deklaratën e palës së dëmtuar të dhënë në shqyrtim fillestar se tani me të akuzuarin kanë raporte të mira, gjithashtu gjykata me rastin e vendosjes mbi llojin e dënimit dhe atë të dënimit alternativ – dënim me kusht, mori për bazë se i akuzuari J. R., nuk rezulton se në të kaluarën ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë, është i gjendjes se dobët ekonomike, konkretisht përfitues i ndihmave sociale. Megjithatë, gjykata i ka shqiptuar dënimin me unik burgim prej shtatë (7) muaj dhe ka lënë një periudhë të verifikimit prej dy vite në mënyrë që i akuzuari J. ta kupton rëndësinë e dëmit dhe se gjykata të bindet se i njëjti nuk do të përsërisë veprimet e tij.

Të akuzuarit F. R. i shqiptoj dënimin dënim me burgim prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i njëjti nuk kryen vepër të re penale. Gjykata dënimin me burgim e shqiptoi për faktin se për veprën penale *Lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së*, është paraparë dënim në mënyrë alternative me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vite. Gjykata përkitazi me dënimin me kusht morri për bazë edhe kërkim faljen e të akuzuarit si dhe deklaratën e palës së dëmtuar të dhënë në shqyrtim fillestar se tani me të akuzuarin kanë raporte të mira, gjithashtu gjykata me rastin e vendosjes mbi llojin e dënimit dhe atë të dënimit alternativ – dënim me kusht, mori për bazë se i akuzuari F. R., nuk rezulton se në të kaluarën ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë, është i gjendjes se dobët ekonomike. Megjithatë, gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim prej tre (3) muaj dhe ka lënë një periudhë të verifikimit prej një viti në mënyrë që i akuzuari F., ta kupton rëndësinë e dëmit dhe se gjykata të bindet se i njëjti nuk do të përsërisë veprimet e tij.

Gjykata me këtë dënim konsideron se të akuzuarit e kanë kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme, kanë kërkuar falje para gjykatës dhe duke premtuar se në të ardhmen nuk do ti përsërisin veprimet e tilla. Gjykata vlerëson se kryesit e veprave penale, në rastin konkret J. dhe F. R., do t'i kuptojnë rëndësinë e veprave penale të cilën i kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejnë veprë penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga nenet 38 dhe 47 të KPRK-se. Gjykata ka bindjen se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve.

Nga të gjitha këto, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla kundërligjore, si dhe një dënim i tillë do t'i parandalojë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Në rastin konkret siç është theksuar edhe më sipër, po që se gjykata nuk do të gjente asnjë rrethanë lehtësuese, marrë për bazë rrethanat rënduese të rastit, të akuzuarve do t'ju shqiptonte dënim edhe më të ashpër. Megjithatë kjo gjykatë konsideron që ky dënim është i mjaftueshëm dhe i domosdoshëm që të akuzuarit të kuptojnë rëndësinë e veprave penale që i kanë kryer e po ashtu edhe rëndësinë që ka për pasojë sanksioni penal.

Gjykata, konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, të akuzuarin e ka liruar pjesërisht nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë dhe kompensimin në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, për faktin se i njëjti është përfitues i Skemës Sociale sipas kartelës për ndihmë Sociale me numër të regjistrimit 50954 dhe se ngarkimi me pagesën e shpenzimeve të procedurës do të ishte barrë e rënd për të dhe do të ndikonte në mirëqenien e tij ekonomike, mirëpo të njëjtin e ka obliguar që të paguaj shpenzimet për ekspertizën mjeko-ligjore të punuar nga dr.Naim Haliti të datës 15.12.2019, shumën prej njëzet (20) Euro.

Gjykata, konform nenit 450 par.2 nën par.6 të KPPRK-së, të akuzuarin F. R. e ka obliguar që t'i paguajë shumën prej njëzet (20) Euro në emër të paushallit gjyqësor, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata i obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej 30 euro në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi në kuptim të nenit 461 të KPPRK-së, pasi që e dëmtuara E. Z., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.10/20, datë 08 gusht 2022

Sekretari juridik,
Ilvi Raba

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës së pranimimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.